

Raport Muaji Shtator 2017

Informacion bazë

| | |
|--|---|
| Menaxhimi i Fondit | Raiffeisen INVEST |
| Monedha | Euro |
| Datë Lancimi | 22 Nentor 2012 |
| Vlera fillestare e kuotës | 100 |
| Shuma fillestare minimale | 250 |
| Shuma minimale pasuese | 50 |
| Komision në hyrje | 0% |
| Komision në dalje | 0% |
| Komision Administrimi në vit | 1.50% |
| Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta | Referojuni informacionit ne deget e RBAL |

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të mund t'i sigurojë investitorit një kthim nga investimi në perputhje me një menaxhim të kujdesshëm të portofolit duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit të nevojshëm.


Nje pjese e rendesishme e asetëve të fondit mund të investohen në bono dhe obligacione thesari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të emetuara në monedhën euro. Megjithatë, frekuenca e emetimeve në euro nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të përcaktojë shkallën në të cilën Fondi do të investojë në këto lloje instrumentesh.

Fondi është i përshtatshëm për individë dhe subjekte juridike të cilët mendojnë se objektivi i investimit i Fondit përputhet me kërkesat dhe pritshmëritë e tyre.

Profili i Riskut të investitorit

Risk i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë
Përfitimet tipike më të larta




Fondi është në kategorinë e dytë të Profilit të Riskut

Të dhëna për Fondin në 30.09.2017

| | |
|---|--------------------|
| Vlera Neto e Aseteve | 111,237,052 |
| Numri i investitoreve | 4,450 |
| Cmimi i Kuotes | 116.4763 |
| *Kthimi vjetor nga investimi (30.9.2016-30.9.2017) | 1.51% |

*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e Portofolit të investimeve në 30 Shtator 2017




Portofoli i fondit Euro është ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga balancimi i kategorive të ndryshme të investimeve në bono dhe obligacioneve qeveritare dhe të korporatave. Kjo bëhet me qëllim për të diversifikuar portofolin dhe ulur rrezikun që vjen nga ekspozimi i gjere ndaj pak instrumenteve.

Perqindja e alokimit të asetëve bëhet në përputhje me politiken e investimit dhe kriteretë të specifikuar në prospektin e fondit. Shpërndarja e asetëve mund të jetë jashtë objektivit të përcaktuar për shkak të ndryshimeve të kushteve të tregut. Asetet e Fondit janë të investuar në instrumente financiare që i përkasin emetuesve që performojnë në industri të ndryshme të ekonomisë duke bërë të mundur rritjen e diversifikimit të portofolit.

Obligacionet të quajtura “dytesore” (ose me termin financiar subordinated) përbejnë afërsisht 5.39% të portofolit në fund të muajit Shtator.


Duke iu referuar strukturës së portofolit të investimeve të fondit në datën 30 Shtator 2017, 45.74% e asetëve të fondit janë të investuar në obligacione qeveritare dhe 36.73% e tyre i përkasin emetimeve të Qeverisë Shqiptare. Perqindja e alokimit të asetëve në depozita afatshkurtra qëndron e lartë në thirrje 10% të asetëve të fondit, ndërsa përafërsisht 19% e asetëve të fondit janë investuar në Fonde investimi, të cilat gjithashtu kanë në fokus investime në tregun e obligacioneve.

Strategjia e investimeve nuk ka pesuar ndryshime dhe Fondi nuk kreu investime te reja gjate Shtatorit. Vlera neto e aseteve te fondit qendron relativisht e pandryshuar ne krahasim me fund-Gushtin duke arritur nivelin e EUR 111.2 milione me 30 Shtator 2017.



Ecuria e çmimit të kuotës deri ne 30 Shtator 2017

Gjate muajit Shtator çmimi i kuotes i fondit Raiffeisen Invest Euro vijoi trendin rrites por performanca ka pesuar nje ulje te lehte si rrjedhoje e luhatshmerise ne tregjet financiare nderkombetare. Ne pjesen e pare te muajit, yield-et e obligacioneve pesuan renie dhe obligacionet nga vendet e Eurozonës gjeneruan fitime të mira, duke perfituar nga rritja e mirë ekonomike e rajonit. Fondi përfitoi nga kjo prirje pozitive e tregut. Ne vazhdim, me rritjen e prospektit per nderprerje te programit te blerjes se obligacioneve nga Banka Qendrore Europiane, rritja e pergjithshme e yield-eve te obligacioneve ka bere qe Fondi te humbase nje pjese te fitimeve te kryera me pare gjate muajit.



Kthimi vjetor neto nga investimi ne fondin Raiffeisen Invest Euro vazhdon te jete shume i mire dhe konkurrues ne raport me alternativat e tjera te investimit ne tregun shqiptar. Kthimi net per periudhen 1-vjecare Shtator 2016- Shtator 2017 rezultoi 1.51%. Performanca e fondit eshte shume me e larte se norma mesatare e interesit e tregut per depoziten 1-vjecare ne monedhen Euro, e cila per te njejten periudhe qendronte ne nivelin e 0.16%. Cmimi i kuotes eshte rritur me 2.32% qe nga fillimi i vitit 2017.

Ne inkurajojme investoret te kene nje horizont sa me te gjate investimi, ne menyre qe te perfitojne kthimin maksimal nga investimi, dhe te mos rrezikojne duke dale nga fondi ne momentin e gabuar. Portofoli i fondit Euro mund te ripozicionohet per te adresuar zhvillimet me te fundit te tregjeve financiare.

Informacion mbi ecurine e tregjeve financiare kombetare dhe nderkombetare per Shtator 2017

Fokusi i tregjeve nderkombetare Europiane gjate muajit Shtator ishte mbi vendimmarrjen e bankave qendrore per normat e interesit. Per sa u perket ketyre te fundit, Banka Qendrore Europiane u shpreh ne mbledhjen e Shtatorit se do te publikoje planet per t'i dhene fund programit 2 trilion-dollarsh te stimulit ekonomik gjate muajve ne vijim, duke e cuar Euron ne nivelet me te larta te dy viteve te fundit. BQE pritet te filloje te reduktoje programin e blerjes se obligacioneve gjate vitit 2017 nxitur prej permiresimeve ne ekonomine e Eurozones dhe mes frikes per pamjaftuesmeri obligacionesh te vlefshme per t'u blere.

Nderkohe, Banka Qendrore Amerikane ishte ne te njeten linje mendimi me BQE. Kreu i Rezerves Federale Amerikane, Janet Yellen, gjate fjales se saj ne mbledhjen vjetor te Shoqates Komberate te Ekonomise ne Ohio, u shpreh se politikeberesit duhet te jene te kujdesshem me "levizjet shume graduale" ne politiken monetare paveresisht "pasigurive domethenese" rreth normes se inflacionit. Pas fjales se Yellen, tregjet inkorporojne nje probabilitet prej 64% per nje rritje te normes se interesit brenda 2018 dhe per dy rritje te metejshme gjate 2018.

Obligacionet qeveritare u shiten ne mase gjate javes se fundit te muajit, duke ulur cmimet e rritur normat e tyre. Ne teresi, prospekti i politikave monetare shtrenguese se bashku me perpjektet me te fundit te administrates Trump per te miratuar reformen e re fiskale qe parashikon lehtesira per bizneset kane bere qe investoret te zhvendosen nga obligacionet ne asetete te tjera.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë nje premtim apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithë shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investoret per te nxjerre konkluzione per te ardhmen. Investitorët e mundshëm janë të ftuar të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit.

Raiffeisen Invest dhe bankieret e Raiffeisen Bank nuk garantojne nje kthim te caktuar te fondit. Informacioni mbi cmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen INVEST sha., në web site www.raiffeisen-invest.al, ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.